



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I BASENIT UJOR DRIN-BUNË

VENDIM

Nr.19, datë 05.12.2024

PËR

**MIRATIMIN E LEJES “PËR PËRDORIM BURIMI UJOR
SIPËRFAQËSOR PËR PRODHIM HIDROENERGJETIK”, TË
SHOQËRISË “V.B NERGUTI” SH.P.K.**

Në mbështetje të pikës 2, nenit 50, të ligjit nr.111/2012, “Për menaxhimin e integruar të burimeve ujore”, të ndryshuar, vendimit nr.550, datë 15.7.2020, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e formularëve të kërkesës për miratimin, në parim, për dhënien me koncesion të përdorimit të burimit ujor, e lejes/autorizimit për përdorim burimi ujor, veprimtari ndërtimore në brigje, veprimtari në shtratin e burimit ujor, shkarkime të lëngshme, përdorimin dhe ripërdorimin e ujërave të përdorura, të ndotura, të dokumenteve shoqëruese, të procedurës së shqyrtimit e të vendimmarrjes dhe të afateve të vlefshmërisë së tyre”, me propozimin e Agjencisë së Menaxhimit të Burimeve Ujore, Këshilli i Basenit Ujor Drin-Bunë,

V E N D O S I:

1. Miratimin e lejes “Për përdorim burimi ujor sipërfaqësor për prodhim hidroenergjetik” nëpërmjet HEC EL-EN, të shoqërisë “V.B NERGUTI” sh.p.k., me vendndodhje: në përroin e Leshnicës, Fshati Qinamak, Bashkia Kukës, Qarku Kukës.

2. Treguesit paraprak janë si më poshtë:

HEC “EL-EN”

Vepra e marrjes (KRGJSH):

- X= 527852
- Y= 4652408
- Z= 535 m.m.n.d

- Qmes-vjet = 1.59 m³/s
- Qllog = 2.1 m³/s
- Qeko = 0.09 m³/s

Godina e Centralit (KRGJSH):

X= 528767

Y= 4656118

Z=442 m.m.n.d

Fuqia e instaluar N= 1400 kW

Energjia Vjetore E= 5 040 000 kWh/vit.

3. Leja e përdorimit të burimit ujq për prodhim hidroenergjetik jepet me kusht që të mos kufizohet furnizimi me ujë të pijshëm, nevojat e bujqësisë në zonë dhe rezerva e domosdoshme ekologjike.

4. Ngarkohet Ngarkohet Agjencia e Menaxhimit të Burimeve Ujqore për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas njoftimit të përmbajtjes së vendimit subjektiv

KRYETARI I KBU DRIN-BUNË

MAJLINDA ANGONI

